



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.07.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e rregullores “Për bashkimin e procedimeve disiplinore në rastet kur një gjyqtar dhe një prokuror janë të përfshirë në të njëjtën shkelje””, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:14 dhe mbaroi në orën 14:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|---------------------------------|
| 1. Ilir Rusi | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. Klodian Kurushi | <i>(anëtar)</i> |
| 3. Fatmira Luli | <i>(anëtare)</i> |
| 4. Gentiana Muçaj | <i>(anëtare)</i> |
| 5. Ridvan Hado | <i>(anëtar)</i> |
| 6. Alban Toro | <i>(anëtar)</i> |
| 7. Markelian Koça | <i>(anëtar)</i> |
| 8. Yllka Rupa | <i>(anëtare)</i> |
| 9. Emona Muçi | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 2. Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 4. Valbona Bala, eksperte pranë EWMI/INL.**
- 5. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).**
- 6. Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice.**
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e rregullores “Për bashkimin e procedimeve disiplinore në rastet kur një gjyqtar dhe një prokuror janë të përfshirë në të njëjtën shkelje””, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor.

Ilir Rusi: Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas njoftimit të bërë, për shkak të krijimit të kuorumit të nevojshëm, mbledhjen e deklaroj të hapur, të ditës së sotme, datë 09.07.2024.

Ju bëj me dije që për arsye objektive nuk është prezent sot Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe mbledhja do të drejtohet nga unë, Ilir Rusi, Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu nuk është prezent, po për arsye objektive, edhe anëtarja znj. Plaku.

Në vijim të kësaj mbledhjeje, vazhdojmë me pikën e parë të saj që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e rregullores “Për bashkimin e procedimeve disiplinore në rastet kur një gjyqtar dhe një prokuror janë të përfshirë në të njëjtën shkelje””, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni Disiplinor.

Për më tej fjalën relatorit z. Hado.

Ridvan Hado: Faleminderit!

Projektvendim “Për miratimin e rregullores “Për bashkimin e procedimeve disiplinore në rastet kur një gjyqtar dhe një prokuror janë të përfshirë në të njëjtën shkelje disiplinore””.

Nevoja për hartimin e këtij vendimi vjen në zbatim të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 140/2 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i cili parashikon se: “2. Në raste kur një gjyqtar ose një prokuror janë të përfshirë në të njëjtën shkelje, Këshillat vendosin bashkimin e procedimeve. Këshillat miratojnë rregulla të përbashkëta për bashkimin e procedimeve”.

Gjithashtu është një detyrim nga Rezoluta e Kuvendit në vitin 2023, një nga rekomandimet që lidhet me Këshillin e Lartë Gjyqësor, për marrjen e masave nga të dy Këshillat për miratimin e këtij akti.

Projekt - Rregullorja “Për bashkimin e procedimeve disiplinore në rastet kur një gjyqtar dhe një prokuror janë të përfshirë në të njëjtën shkelje disiplinore”, siç e thashë bazohet në nenin 140, paragrafi i dytë i ligjit “Për statusin”.

Hartimi dhe konsultimi i aktit:

Rregullorja për bashkimin e procedimeve disiplinore në rastet kur një gjyqtar dhe një prokuror janë të përfshirë në të njëjtën shkelje disiplinore është produkt i bashkëpunimit të ngushtë me Projektin EU4Justice, i cili ofroi mbështetje teknike për Këshillin e Lartë Gjyqësor, në përmbushjen e objektivave të tij.

Komisionet Disiplinore të të dy Këshillave, kanë organizuar takime konsultuese në lidhje me këtë çështje, duke evidentuar dhe vështirësinë përkatëse për miratimin e këtij akti të përbashkët.

Sa sipër, me fillimin e zbatimit të projektit dhe me vendosjen e ekspertëve të tyre pranë KLGJ-së e KLP-së, nga ana e Komisionit Disiplinor u kërkua mbështetja dhe asistenca e projektit për hartimin e aktit.

Në diskutim me ekspertët e projektit, u ngrit grupi i punës në përbërje të të cilit ishin anëtarët e Komisionit Disiplinor të KLGJ-së, anëtarët e Komisionit Disiplinor të KLP-së, përfaqësues nga ILD-ja, si dhe ekspertët e projektit.

Grupi i punës zhvilloi disa takime. Fillimisht u dakordësua në lidhje me pikat kyçe të draftit, elementët kryesorë të tij dhe më pas, puna vijoi me hartimin dhe paraqitjen e një projekti fillestar, ku një kontribut të rëndësishëm dhanë edhe ekspertët e projektit, dhe ekspertët ndërkombëtarë.

Struktura e projekt-rregullores:

Projekt-rregullorja është e organizuar në dy krerë.

Në kreun e parë, titulluar “Dispozita të përgjithshme”, janë vendosur nene të cilat sanksionojnë rregullime me natyrë të përgjithshme, të cilat qëndrojnë në themel të të gjitha parashikimeve të organizimit dhe funksionimit të Komisioneve Disiplinore të të dy Këshillave, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas kësaj projekt-rregulloreje.

Qëllimi i rregullores është hartimi i rregullave që duhet të ndiqen për bashkimin e procedimeve, në rastet kur një gjyqtar dhe një prokuror janë të përfshirë në të njëjtën shkellje disiplinore. Janë pasqyruar parimet e përgjithshme bazuar në parashikimet ligjore të Ligjit për Statusin.

Në nenin 1 përcaktohet qëllimi i kësaj rregulloreje për hartimin e rregullave për procedim të përbashkët.

Në nenin 2 janë të vendosura parimet e përgjithshme dhe gjithashtu është përcaktuar parimi që në për çështjet që nuk janë të rregulluara në mënyrë specifike zbatohet procedura e rregulluar sipas ligjit “Për statusin”.

Neni 3 parashikon fillimin e procedurës nga ILD.

Në nenin 4 është përcaktuar parimi i përpunimit të dosjeve, parimi i sovranitetit të secilit Këshill në vendimmarrje. Afati kohor brenda të cilit të dy Këshillat duhet të marrin vendimin nëse janë dakord për bashkimin ose jo të procedimeve. Si dhe të njoftojnë njëra-tjetrën për çdo lloj vendimmarrje që kanë.

Në nenin 5 janë rastet e ndarjes së procedimeve pas bashkimit, që janë të parashikuara nga nenet 138/5, 139, 144 dhe 145. Këto janë raste specifike të ndarjes.

Në nenin 6 është procedura që do të zbatohet gjatë procedimit të përbashkët të dy magistratëve, pra të një gjyqtari dhe një prokurori, që ka të bëjë me formalizimin e kontakteve ndërmjet relatorëve të procedimit të përbashkët të të dy Këshillave,

formalizimi pra, ruajtja e konfidencialitetit dhe unifikimi sa të jetë e mundur për përgjigjet, për datën dhe vendimmarrjen.

Ju faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit z. Hado!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vijojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për miratimin e rregullores “Për bashkimin e procedimeve disiplinore në rastet kur një gjyqtar dhe një prokuror janë të përfshirë në të njëjtën shkelje disiplinore””.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Miratimin e Rregullores “Për bashkimin e procedimeve disiplinore në rastet kur një gjyqtar dhe një prokuror janë të përfshirë në të njëjtën shkelje disiplinore”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.07.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për zëvendësimin e nëpunëses përgjegjëse për vlerësim znj. {...} në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës {...}”, i përgatitur nga Komisioni Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Yllka Rupa).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:14 dhe mbaroi në orën 14:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Markelian Koça | (anëtar) |
| 8. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 9. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 2. Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 4. Valbona Bala, eksperte pranë EWMI/INL.**
- 5. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).**
- 6. Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice.**
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për zëvendësimin e nëpunëses përgjegjëse për vlerësim znj. {...} në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Yllka Rupa).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 2 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për zëvendësimin e nëpunëses përgjegjëse për vlerësim znj. {...} në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, për më tej fjalën znj. Rupa.

Yllka Rupa: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar kolegë!

Në cilësinë e relatores po paraqes relacionin e përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale që ka për objekt zëvendësimin e

nëpunëses përgjegjëse për vlerësim znj. {...} në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}.

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 371, datë 13.09.2022 “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtarët pjesë e programit të vlerësimit për vitin 2021”, ka filluar vlerësimin etik dhe profesional për znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Nëpërmjet procedurës së shortit, për vlerësimin e gjyqtares janë përzgjedhur relatorët, në cilësinë e relatores unë, Yllka Rupa dhe në cilësinë e nëpunëses përgjegjëse për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

Pas marrjes së këtij vendimi, ka vijuar procedura e vlerësimit sipas parashikimeve të nenit 86 e vijues të Ligjit të Statusit, duke u kryer veprimet procedurale si më poshtë. Gjyqtarja është njoftuar për vendimin, për fillimin e procedurës së vlerësimit për periudhën 2017-2019 dhe emrat e vlerësuesve, nëpërmjet postës elektronike.

Gjyqtarja ka konfirmuar marrjen e njoftimit dhe ka deklaruar se është dakord me vlerësuesit.

Gjithashtu i është dërguar gjyqtares dhe kryetarit të gjykatës “Formulari i integruar i vlerësimit të gjyqtarit” së bashku me njoftimin për afatet e plotësimit të tij.

Është kërkuar informacion nga Shkolla e Magjistraturës lidhur me pjesëmarrjen e gjyqtares në programin e formimit vazhdues.

Janë kërkuar të dhëna për verifikimin e ankesave dhe masave disiplinore ndaj gjyqtares {...}.

Nga ana tjetër ILDKPKI ka dërguar raportin përkatës mbi mungesën e konfliktit të interesit.

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 204, datë 17.04.2024, ka vendosur zëvendësimin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha, për shkak të mbarimit të afatit të komandimit. Nëpërmjet procedurës së shortit, për vlerësimin e gjyqtares {...}, është përzgjedhur nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. {...}.

Me emalin e datës 17.04.2024, i është njoftuar gjyqtares {...}, zëvendësimi i nëpunësit përgjegjës për vlerësimin. Më datë 22.04.2024, gjyqtarja ka konfirmuar marrjen e njoftimit dhe ka deklaruar se duke qenë në cilësinë e gjyqtares në proces

vlerësimi ka kërkuar përjashtimin e znj. {...}, nga procedura e vlerësimit. Sipas gjyqtares {...} shkak i përjashtimit konsiston në faktin se në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues ka dhënë një vendim penal që afekton ndaj një familjari shumë të afërt të znj. {...}.

Nga ana e nëpunëses përgjegjëse për vlerësimin, znj. {...} ka paraqitur edhe ajo kërkesë për heqje dorë nga procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, me përmbajtjen e së cilës ju jeni njohur.

Me vendimin nr. 9, datë 18.06.2024, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 31 dhe 32 të Kodit të Procedurës Administrative, nenit 59 dhe 80 të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, si edhe në kërkesën e znj. {...}, ka vendosur:

“Pranimin e kërkesës së znj. {...}, nëpunëse përgjegjëse pranë Njësisë së Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarëve, për heqjen dorë nga procedura e vlerësimit etik dhe profesional të znj. {...}, për periudhën e vlerësimit 2017-2019”.

Lidhur me caktimin dhe zëvendësimin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin, në nenin 12, pika 2 të vendimit nr. 263, datë 21.11.2019 “Rregulla plotësuese për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit”, parashikohet se: “...mbledhja plenare e Këshillit cakton me short relatorin dhe nëpunësin përgjegjës për çdo vlerësim, duke mbajtur parasysh, për aq sa është e mundur, barazinë e shpërndarjes së punës...”.

Për sa më sipër, Komisioni i propozon mbledhjes plenare zëvendësimin e nëpunëses përgjegjëse për vlerësimin znj. {...}, në procedurën e vlerësimit etik dhe profesional të filluar, por të papërfunduara prej saj me hartimin e raportit analitik për periudhën e vlerësimit 2017-2019 për gjyqtaren {...}.

Sa i përket procedurës së shortit ajo do të bazohet në barazinë e shpërndarjes së ngarkesës së punës. Referuar prioriteteve dhe urgjencës që procesi i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të filluar tashmë, fazën në të cilën ndodhen procedurat e vlerësimeve, si dhe ngarkesën e tre nëpunëseve të tjera, Komisioni propozon që në cilësinë e nëpunëses përgjegjëse për këtë procedurë të jetë znj. Entela Gjoni.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet zëvendësimi i nëpunësit përgjegjës znj. {...} për vlerësim në procedurën e papërfunduar të vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit për gjyqtaren {...}.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet caktimi i nëpunëses përgjegjëse për vlerësim znj. Entela Gjoni.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit znj. Rupa!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për zëvendësimin e nëpunëses përgjegjëse për vlerësim znj. {...} në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Zëvendësimin e nëpunësit përgjegjës për vlerësim znj {...}, në procedurën e papërfunduar të vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtaren {...}.

2. Caktimin e nëpunësit përgjegjës për vlerësim znj. Entela Gjoni, në procedurën e vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtaren {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.07.2024)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr.301, datë 18.06.2024 “Për caktimin e trupës së gjyqtarëve udhëheqës për periudhën tetor 2024 - tetor 2027””, i përgatitur nga Komisioni Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Emona Muçi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:14 dhe mbaroi në orën 14:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Markelian Koça | (anëtar) |
| 8. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 9. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 2. Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 4. Valbona Bala, eksperte pranë EWMI/INL.**
- 5. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).**
- 6. Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice.**
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr.301, datë 18.06.2024 “Për caktimin e trupës së gjyqtarëve udhëheqës për periudhën tetor 2024 - tetor 2027””, i përgatitur nga Komisioni Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore *znj. Emona Muçi*).

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me pikën 3 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr.301, datë 18.06.2024 “Për caktimin e trupës së gjyqtarëve udhëheqës për periudhën tetor 2024 - tetor 2027””, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Për më tej fjalën relatores *znj. Muçi*.

Emona Muçi: Faleminderit!

Në lidhje me projektvendimin “Për një ndryshim në vendimin nr.301, datë 18.06.2024 “Për caktimin e trupës së gjyqtarëve udhëheqës për periudhën tetor 2024 - tetor 2027””, Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim Këshilli), bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

përcakton gjykatat e shkallës së parë pranë të cilave kandidatët për gjyqtarë, në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, do të kryejnë praktikën profesionale. Me vendimin nr. 301, datë 18.06.2024 Këshilli ka proceduar për caktimin e trupës së gjyqtarëve udhëheqës pranë të cilëve kandidatët për gjyqtarë do të kryejnë praktikën profesionale, përgjatë tre viteve (tetor 2024- tetor 2027).

Për qëllim caktimin e trupës së gjyqtarëve udhëheqës, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Personale (në vijim Komisioni) i është drejtuar me thirrje për të shprehur vullnetin për të qenë pjesë e kësaj trupe, të gjithë gjyqtarëve që plotësojnë kushtet ligjore, të cilët ushtrojnë funksionin në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrativ, gjykata të kategorisë të parë dhe të dytë (të mëdha dhe të mesme) dhe me infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e praktikës profesionale të kandidatëve për gjyqtarë. Konkretisht, i është drejtuar thirrje për shprehje interesi gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Korçë dhe Vlorë.

Në përgjigje të kësaj thirrje, kanë shprehur gatishmërinë për t'u bërë pjesë e listës 38 gjyqtarë, 29 prej të cilët kanë qenë pjesë e listës edhe për periudhën 2021-2024 dhe kanë ndjekur programin e trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës në vitet 2021-2024.

Pas miratimit të listës me vendimin nr.301, datë 18.06.2024 të Këshillit dhe komunikimit të këtij vendimi gjykatave respektive, nga ana e disa gjyqtarëve është shprehur rishtazi gatishmëria për të qenë pjesë e listës të trupës së gjyqtarëve udhëheqës.

Konkretisht gjyqtari {...}, nëpërmjet postes elektronike të datës 20.06.2024 ka shprehur interesin për të qenë pjesë e trupës udhëheqëse duke parashtruar se “Për arsye të mos rakordimit të email-it tuaj dërguar më datë 22.05.2024 për shkak të ngarkesës së madhe, duke qenë se për disa vite rresht kam ushtruar edhe detyrën e gjyqtarit udhëheqës, deklaroj gatishmërinë time për të qenë pjesë e trupës së gjyqtarëve udhëheqës, pranë të cilëve do të kryejnë stazhin profesional kandidatët për gjyqtarë”. Të njëjtat argumente janë dërguar në datën 24.06.2024 edhe nga gjyqtari {...}, duke shprehur kështu interesin për të qenë pjesë e trupës së gjyqtarëve udhëheqës për periudhën 3-vjeçare.

Po kështu, kanë shprehur interesin për t'u përfshirë në këtë listë edhe gjyqtarët:

- znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...} gjyqtarë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;

- znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;

- znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier;

- z. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe znj. {...} gjyqtarë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;

- z. {...} dhe z. {...}, gjyqtarë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Në lidhje kriteret ligjore që duhet të plotësohen për t'u përfshirë në trupën e magjistratëve gjyqtarë udhëheqës, në nenin 33, pika 3 të ligjit nr. 96/2016, parashikohet se: Këshillat caktojnë një trupë magjistratësh udhëheqës, me një kohëzgjatje prej tre vjetësh, me të drejtë riemërimi. Çdo magjistrat udhëheqës duhet të përmbushë njëkohësisht këto kriterë:

a) të ketë të paktën pesë vjet përvojë si gjyqtar ose prokuror;

b) të jetë vlerësuar në përputhje me këtë ligj, të paktën “shumë mirë” në vlerësimin e fundit etik dhe profesional;

c) të ketë përfunduar me sukses trajnimin për udhëheqës në tri vitet e fundit, në Shkollën e Magjistraturës;

ç) të mos ketë qenë subjekt i masave disiplinore;

d) të ketë respektuar afatet ligjore për hetimin apo gjykimin e çështjeve, të paktën në vitin paraardhës përpara se të caktohet si udhëheqës..”.

Nga informacioni i marrë nga Njësia e Burimeve Njerëzore pranë KLGJ-së rezulton se gjyqtarët që kanë shprehur rishtazi vullnetin për të qenë pjesë e trupës së gjyqtarëve udhëheqës, kanë mbi 5 vjet përvojë si gjyqtar dhe nuk kanë qenë subjekte të masave disiplinore. Lidhur me kriterin për përfundimin me sukses të trajnimit për udhëheqës në tri vitet e fundit, referuar informacionit të përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës me shkresën nr. {...} prot., datë 20.05.2024, protokolluar në Këshill me nr. {...} prot., datë 20.05.2024, rezulton se 9 prej tyre kanë përfunduar me sukses trajnimet për udhëheqës, konkretisht gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Sa i përket kriterit të përcaktuar në nenin 33, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr. 96/2016, për vlerësimin etik dhe profesional të fundit në nivelin, të paktën “shumë mirë”, një pjesë e gjyqtarë të cilët kana shprehur interesin për t’u përfshihen rishtazi në listën, nuk rezulton të kenë aktualisht vlerësim etik dhe profesional sipas Ligjit për Statusin, por duke konsideruar procedurat e vlerësimit që kanë filluar nga Këshilli dhe nevojën për zgjerimin e listës së gjyqtarëve udhëheqës për t’iu përgjigjur numrit në rritje të kandidatëve për gjyqtarë në vitet në vijim, është vlerësuar përfshirja në këtë listë edhe të këtyre gjyqtarëve që kanë shprehur gatishmërinë e tyre, pas miratimit të listës me vendimin nr.301, datë 18.06.2024, si dhe kanë qenë më parë gjyqtarë të caktuar në trupën e gjyqtarëve udhëheqës.

Lidhur me kriterin e përcaktuar në nenin 33, pika 3, shkronja “d” të ligjit nr. 96/2016, sa i përket respektimit të afateve ligjore për gjykimin e çështjeve, të paktën për vitin e fundit, aktualisht jemi në pamundësi objektive për marrjen e këtij informacioni për këta gjyqtarë, por nisur nga pasojat ligjore që sjell mosrespektimi i afateve ligjore në gjykimin kryesisht të kërkesave të ngutshme me afate ligjore të përcaktuara në ligjin procedural, ka një prezumim që ato respektohen nga të gjithë gjyqtarët.

Në pikën 1 të projektvendimit, parashikohet ndryshimi i trupës së gjyqtarëve udhëheqës, të miratuar me vendimin nr.301, datë 18.06.2024, për një periudhë trevjeçare (tetor 2024 - tetor 2027), me të drejtë riemërimi, sipas listës bashkëngjitur këtij projektvendimi. Në këtë listë janë përfshirë (i) të gjithë gjyqtarët e listës së mëparshme, (ii) gjyqtarët që kanë shfaqur rishtazi vullnetin, si dhe që plotësojnë kushtet ligjore të parashikuara nga neni 33, pika 3 shkronjat “a”, “ç” dhe “d” të ligjit nr. 96/2016.

Në pikën 2 të projektvendimit është përcaktuar detyrimi i magjistratëve udhëheqës për t’u angazhuar në ndjekjen e trajnimeve të nevojshme pranë Shkollës së Magjistraturës. Ky detyrim vlen për të gjithë gjyqtarët, sidomos për gjyqtarët e rinj të përfshirë në listë, me qëllim përgatitjen e tyre për programin e praktikës profesionale, si dhe për vlerësimin etik dhe profesional që i bëhet kandidatëve për gjyqtarë në përfundim të kësaj praktike.

Në pikën 3 të projektvendimit parashikohet njoftimi i tij gjyqtarëve respektivë dhe Shkollës së Magjistraturës, me qëllim përfshirjen e gjyqtarëve udhëheqës në programin e

trajnimin, si dhe njoftimi i gjyqtarëve udhëheqës dhe gjykatave në të cilat ata ushtrojnë funksionin.

Së fundmi, parashikohen momenti i hyrjes në fuqi të vendimit me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, referuar parashikimeve të nenit 98 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Në rast se dëshironi të lexoj edhe listën, apo do ta lexoni juve me vendimmarrjen?

Ta lexoni me vendimmarrjen atëherë.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Keni diskutime për sa u parashtrua?

Atëherë, edhe një herë, keni diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk keni diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për një ndryshim në vendimin nr.301, datë 18.06.2024 “Për caktimin e trupës së gjyqtarëve udhëheqës për periudhën tetor 2024 - tetor 2027””.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Të ndryshojë trupën e gjyqtarëve udhëheqës, për periudhën trevjeçare (tetor 2024 – tetor 2027), të miratuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.301, datë 18.06.2024, sipas listës bashkëngjitur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Përmbajtja e listës është kjo:

1. {...};

2. {...};

3. {...};
4. {...};
5. {...};
6. {...};
7. {...};
8. {...};
9. {...};
10. {...};
11. {...};
12. {...};
13. {...};
14. {...};
15. {...};
16. {...};
17. {...};
18. {...};
19. {...};
20. {...};
21. {...};
22. {...};
23. {...};
24. {...};
25. {...};
26. {...};
27. {...};
28. {...};
29. {...};
30. {...};
31. {...};
32. {...};
33. {...};

34. {...};
35. {...};
36. {...};
37. {...};
38. {...};
39. {...};
40. {...};
41. {...};
42. {...};
43. {...};
44. {...};
45. {...};
46. {...};
47. {...};
48. {...};
49. {...};
50. {...};
51. {...};
52. {...};
53. {...};
54. {...};
55. {...}.

2. Gjyqtarët udhëheqës sipas pikës 1 të këtij vendimi, angazhohen për të ndjekur gjatë kësaj periudhe 3-vjeçare, trajnimet e nevojshme pranë Shkollës së Magjistraturës.

3. Ky vendim t'i njoftohet Shkollës së Magjistraturës dhe gjyqtarëve udhëheqës.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të Këshillit.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.07.2024)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimin nga kandidatja znj. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 245, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:14 dhe mbaroi në orën 14:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 2. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Gentiana Muçaj*** (anëtare)
- 5. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 6. Alban Toro*** (anëtar)
- 7. Markelian Koça*** (anëtar)
- 8. Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Valbona Bala, eksperte pranë EWMI/INL.*
5. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
6. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 245, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 4 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 245, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Koça.

Markelian Koça: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar anëtarë!

Në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës ju paraqesim projektvendimin “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 245, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Në relacion ju parashtrojmë se me vendimin nr. 245, datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) është vendosur:

Hapja e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile.

Në këtë procedurë afati i aplikimit ka qenë data 16.05.2024.

Brenda afatit ka kandiduar edhe znj. {...} aktualisht gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Me vendimin nr. 266, datë 24.05.2024 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme... Jo, ka një lapsus këtu në relacion. Kërkoj ndjesë. ...si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 244, nr. 245 dhe nr. 246, datë 02.05.2024”, Këshilli ka vendosur:

Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024; si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 244, nr. 245 dhe nr. 246, datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Është caktuar edhe relatori përkatës për çështjen, që jam unë në rastin konkret për zonzjën {...}.

Në vijim është njoftuar kandidatja në lidhje me fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve ligjore të kandidimit, caktimin e relatorit dhe të drejtën për të

kërkuar përjashtimin e relatorit apo të çdo anëtarit tjetër të Këshillit, brenda një afati 3-ditor. Është njohur me sa më lart dhe kandidatja nuk ka parashtruar ndonjë pretendim në lidhje me relatorin apo anëtarët e tjerë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Më datë 03.06.2024, është njoftuar për plotësimin dhe dorëzimin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

Brenda afatit pesëditor, ka depozituar rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Është kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe figurës për kandidatët për në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ndër ta edhe për znj. {...}.

Nga rezultatet e verifikimit paraprak rezulton që në lidhje me kriterin e përvojës profesionale zonja {...} ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2008 dhe ndërkohë është emëruar për të kryer stazhin profesional si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, për periudhën 2007 deri 2009, ku ka gjykuar çështje me natyrë të përgjithshme, çështje civile dhe penale. Në vijim, ajo është emëruar gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, detyrë të cilën e ka ushtruar për periudhën deri në mars 2021 pasi me vendim të Këshillit është caktuar si pjesë e skemës së delegimit pranë Gjykatës së Apelit Korçë për një periudhë mars 2021 deri shkurt 2023 duke filluar nga data 01.02.2023 dhe rikthehet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve datë 16.12.2021 është zgjedhur Zëvendëskryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Me vendim nr. 134, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë”, nga data 01.05.2023 ushtron funksionin si gjyqtare pranë kësaj gjykate, ku ka gjykuar çështje me natyrë të përgjithshme, çështje civile dhe penale.

Në lidhje me edukimin shkollor, rezulton se ka përfunduar Universitetin e Tiranë, ka marrë titullin “Jurist” në datën 30.06.2005 dhe Shkollën e Magjistraturës në vitin 2008. Me dekretin nr. {...}, datë 05.10.2007 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare dhe caktohet të kryejë stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Me dekret të Presidentit të Republikës, 25.03.2009, emërohet gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Me vendim nr. 105, 25.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, caktohet për të gjykuar si pjesë e skemës së delegimit pranë Gjykatës së

Apelit Korçë, për një periudhë 1 (një) vjeçare. Me vendimin nr. 113, datë 28.03.2022 është pjesë e skemës së delegimit në Gjykatën e Apelit Korçë, për një periudhë tjetër 1 (një) vjeçare. Me vendim të Këshillit të Larë Gjyqësor, 27.01.2023 deklarohet përfundimi para afatit të shërbimit në skemën e delegimit dhe kthimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Vjetërsia në ushtrimin e profesionit të magjistratit është 16 vite.

Zonja {...} nuk rezulton të ketë masa disiplinore, situatë që rezulton nga verifikimet e kryera.

Ndërsa nga shqyrtimi i dokumentacionit, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, rezulton se ka mbi shtatë vite përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë dhe shkallës së dytë.

Sipas informacioneve në vijim nga ana e gjykatës, rezulton të jetë emëruar gjyqtare në 18.10.2007 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. Gjatë kësaj periudhe ka ushtruar funksionin në shkallë të parë dhe ka qenë pjesë e seksionit penal në periudhat 25.03.2009 - 18.01.2011, 23.01.2012 deri 12.01.2015, 21.01.2018 deri në 18.03.2019. Për periudhën nga data 18.03.2019 e në vijim Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë nuk ka funksionuar e ndarë në seksione por ka qenë e ndarë në trupa gjykues për gjykimin e çështjeve civile/penale. Gjyqtare {...} ka gjykuar të gjithë natyrën e çështjeve gjyqësore. Me vendimin nr. {...}, 24.12.2020 të këshillit të gjykatës “Mbi shpërndarjen e gjyqtarëve në seksione dhe trupa gjykues”, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, ka funksionuar si seksion vetëm seksioni penal për të mitur, gjyqtarët e të cilit do të gjykojnë çështjet penale me të pandehur të mitur dhe viktimë të mitur, pjesë e këtij seksioni është dhe gjyqtare {...}.

Nga të gjitha sa u tha më lart në verifikimet nëpërmjet komunikimeve me gjykatën, rezulton që për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 245 datë 02.05.2024, znj. {...} të ketë mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile.

Nuk ka masa disiplinore në fuqi, që u relatua më lart. Janë bërë verifikimet përkatëse dhe po ashtu rezulton që është depozituar edhe deklarata se nuk ka masa disiplinore.

E njëjta gjë konfirmohet edhe nga Departamenti i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Administrative pranë Këshillit.

Ndërsa në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, është administruar sipas përcaktimeve ligjore (që nuk po i lexoj sepse janë të njohura për të gjithë anëtarët), është depozituar në datën 15.05.2024 deklarimi kundrejt përgjegjësisë ligjore se nuk do të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, neni 8 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ndërsa kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidaten znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatë papajtueshmërie.

Sa më lart, është paraqitur materiali për shqyrtim Komisionit, i cili në mbledhjen e datës 24.06.2024, duke konsideruar të plotë procedurën e verifikimit për tre kriteret formale ka vendosur t’i përcjellë mbledhjes plenare shqyrtimin e projektvendimit me dy pikë:

Për verifikimin e plotësisë nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 245, 02.05.2024, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, dhe vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore.

Ju faleminderit për vëmendjen!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Koça!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, kalojmë në votimin e projektvendimit përkatës.

Atëherë, për arsye teknike patëm një shkëputje të vogël. Vazhdojmë, meqenëse nuk kishte diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit të relatuar nga zoti Koça.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 245, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 245 datë 02.05.2024, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 245 datë 02.05.2024.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

27

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.07.2024)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimin nga kandidati z. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:14 dhe mbaroi në orën 14:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
5. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
6. ***Alban Toro*** (anëtar)
7. ***Markelian Koça*** (anëtar)
8. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

29

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 09.07.2024 (Pika 5)***

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Valbona Bala, eksperte pranë EWMI/INL.*
5. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
6. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 5 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Toro.

Alban Toro: Atëherë, në kuadër të përpjekjeve që ka bërë Këshilli i Lartë Gjyqësor për plotësimin e vakancave në sistemin gjyqësor në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimet nr. 245, 246, datë 02.05.2024, ka proceduar me hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit në këtë gjykatë në fushën e së drejtës civile.

Një nga kandidatët ka qenë edhe z. {...}, gjyqtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, aktualisht gjyqtar i skemës së delegimit në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Me vendimin nr. 266, datë 24.05.2024 nga ana e Këshillit ka filluar procedura e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024; si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 244, nr. 245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, duke përcaktuar relatorin përkatës.

Në kuadër të administrimit të këtij kandidimi, nga ana e relatorit janë kërkuar dhe verifikuar kriteret e parashikuara nga nenet 47/4, 48/8 dhe 8 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, natyrisht duke administruar edhe aktet përkatëse. Nga aktet ka rezultuar:

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 05.07.2002 dhe Shkollën e Magjistraturës në vitin 2007. Me dekret nr. {...}, datë 04.10.2006 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtar dhe caktohet të kryejë stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekretin nr. {...}, datë 14.11.2007 të Presidentit të Republikës caktohet gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec. Me dekretin nr. {...}, datë 16.07.2013 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë. Me vendimin nr. {...}, datë 28.10.2013 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë delegohet për të kryer përkohësisht detyrën e Kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

Me vendimin nr. {...}, datë 29.04.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet Kryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë. Me vendimin nr. 243, datë 30.06.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor deklarohet përfundimi i funksionit si Kryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë dhe në vijim ka ushtruar funksionin si gjyqtar pranë kësaj gjykate. Me vendimin nr. 260, datë 15.07.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet për të gjykuar si pjesë e skemës së delegimit pranë Gjykatës Administrative të Apelit, për një periudhë 1 (një) vjeçare. Me vendim nr. 365, datë 13.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor ricaktohet për të gjykuar si pjesë e skemës së delegimit pranë Gjykatës Administrative të Apelit, për një periudhë 3 (tre) vjeçare, ku dhe aktualisht ushtron funksionin. Vjetërsia në ushtrimin e profesionit të magjistratit është 17 vite. Z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Pra në këtë kontekst zoti {...} plotëson dhe pjesën e përgjithshme të përvojës minimale prej 7 vjetësh.

Në lidhje me përvojën specifike të parashikuar nga i njëjti nen, rezulton se sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton se:

“... z. {...}, fillimin në detyrë e ka me dekretin nr. {...}, datë 04.10.2006, ku është emëruar për të kryer stazhin profesional pranë kësaj gjykate dhe më pas me Dekretin nr. {...}, datë 14.11.2007 të Presidentit të Republikës, është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Pogradec, si dhe në vitin 2013 është emëruar gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë. Në lidhje me sa kërkoni, për periudhën kohore për të cilën kërkohet informacioni për përvojën e gjyqtarit z. {...}, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk disponon urdhra të kryetarit për ndarjen në dhoma/seksione të gjyqtarëve. Në mungesë të tyre, bashkëngjitur kësaj shkrese, gjeni në format statistikor, llojet e vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtar z. {...}, për periudhën 2006-2007...”.

Referuar të dhënave të regjistrit të vendimeve civile për vitin 2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kandidati z. {...}, referuar objektit të çështjeve gjyqësore, është shortuar dhe ka gjykuar 2 çështje në lëndë administrative nga 25 çështje në total me natyrë civile.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, rezulton se “...Gjyqtari {...}, me Dekretin

nr. {...}, datë 14.11.2007 të Presidentit të Republikës është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec nga data 14.11.2007 dhe është transferuar në datë 31.10.2013. Për vitin 2007 nuk është gjetur ndonjë urdhër i kryetarit të Gjykatës për ndarjen e gjyqtarëve sipas llojit të çështjeve por është shkresa e KLD “Për caktim gjyqtari në gjykata të rretheve gjyqësore”. Për këtë periudhë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec nuk ka funksionuar e ndarë në seksione (seksion civil/ seksion penal/ seksion administrativ), por ka funksionuar me trupa gjykues për gjykimin e çështjeve civile/ penale. Gjykata ka gjykuar çështje civile-administrative (mikse), ndërsa çështjet e mirëfillta administrative janë dërguar për kompetencë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. Nga verifikimi i kryer në arkivën e gjykatës, rezulton se z. {...} gjatë kësaj periudhe ka gjykuar të gjitha llojet e çështjeve.”.

Ndërkohë, referuar të dhënave, rezulton se z. {...}, nga data 16.07.2013 dhe në vijim, është gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë e më pas Gjykata e Apelit Administrativ e për rrjedhojë që nga kjo datë ai ka gjykuar vetëm çështje me lëndë administrative.

Në këtë kontekst, nga të dhënat rezulton që z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet nr.245 dhe nr. 246, datë 02.05.2024, rezulton të ketë mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile.

Gjithashtu nuk rezulton të verifikohen edhe kriteret penguese siç është pasja e një mase disiplinore në fuqi apo ekzistenca e papajtueshmërisë ambientale.

Në këtë kuadër, nga ana e relatorit ju është përgatitur projekti në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni si më poshtë:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr.245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të

Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr.245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016.

Duke ju falënderuar për vëmendjen!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Ka diskutime për sa u parashtrua nga relatori?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr.245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr.245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.07.2024)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 244 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:14 dhe mbaroi në orën 14:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 2. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Gentiana Muçaj*** (anëtare)
- 5. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 6. Alban Toro*** (anëtar)
- 7. Markelian Koça*** (anëtar)
- 8. Yllka Rupa*** (anëtare)

36

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 09.07.2024 (Pika 6)***

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Valbona Bala, eksperte pranë EWMI/INL.*
5. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
6. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 244 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Ilir Rusi: Në vijim, vazhdojmë me pikën 6 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 244 dhe nr. 246, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, për të cilin është

përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Toro.

Alban Toro: Atëherë, në vijim të plotësimit të vakancave në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, përkatësisht me vendimet nr. 244 dhe nr. 246, datë 02.05.2024, nga ana e Këshillit është proceduar me nisjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në fushën e së drejtës civile. Një nga kandidatet për këto dy pozicione është edhe zonja {...}, aktualisht gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Me vendimin nr. 266, datë 24.05.2024 ka filluar procedura e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë edhe për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile. Me cilësinë e relatorit kam administruar aktet të cilët provojnë plotësimin e kriterëve të parashikuara nga nenet 8, 47/4, 48/8, për këtë kandidate nga e cila ka rezultuar:

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 28.06.2003 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2012. Me dekretin nr. {...}, datë 10.11.2011 të Presidentit të Republikës caktohet të kryejë stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekret nr. {...}, datë 23.01.2014 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat. Me procesverbalin e Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, datë 15.03.2022 zgjidhet Zëvendëskryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe nga data 01.05.2023 ka ushtruar funksionin e titullares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat. Me vendim nr. 518, datë 05.10.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet sipas procedurës së lëvizjes paralele pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ku dhe aktualisht ushtron funksionin. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 12 vite. Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në këtë kontekst zonja {...} plotëson kriterin, atë të përvojës minimale të

përgjithshme mbi 7 vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, sipas urdhrave për ndarjen e gjyqtarëve në dhomë/seksione dhe trupa gjykues për vitet 2014 - 2023, rezulton se:

Për vitin 2014 ka gjykuar në total 342 çështje, 79 penale, 115 Civile , 72 kërkesa penale, 76 kërkesa civile;

Për vitin 2015 ka gjykuar në total 448 çështje, 77 penale, 164 civile, 102 kërkesa penale, 105 kërkesa civile;

Për vitin 2016 ka gjykuar 427 çështje, 79 penale, 181 civile , 97 kërkesa penale, 70 kërkesa civile;

Për vitin 2017 ka gjykuar në total 432 çështje, 73 penale, 137 çështje civile, 86 kërkesa penale, 136 kërkesa civile;

Për vitin 2018, 446 çështje, 56 çështje penale, 128 civile, 187 kërkesa penale, 75 kërkesa civile;

Për vitin 2019, në total 623 çështje, 87 penale, 240 civile , 230 kërkesa penale, 66 kërkesa civile;

Për vitin 2020 ka gjykuar në total 518 çështje, 46 çështje penale, 176 civile, 230 kërkesa penale, 66 kërkesa civile;

Për vitin 2021 ka gjykuar në total 654 çështje, 74 penale, 246 civile, 188 kërkesa penale, 146 kërkesa civile;

Për vitin 2022 ka gjykuar në total 717 çështje, 90 penale, 260 civile , 201 kërkesa penale, 164 kërkesa civile;

Për vitin 2023 ka gjykuar në total 343 çështje, nga të cilat 41 penale, 119 civile, 103 kërkesa penale, 80 kërkesa civile. Në 6 çështje penale dhe 5 çështje civile ka qenë anëtare e trupit gjykues. Në total gjithsej 354 çështje.

Është administruar urdhri nr. 93, 04.11.2013 për shkrirjen e dhomave civile dhe penale dhe me Urdhrin nr. 25 datë 31.01.2014, Urdhër nr. 80 datë 17.04.2014, Urdhër nr. 5 datë 12.01.2015, Urdhër nr. 3 datë 04.01.2017, Urdhër nr. 3 datë 04.01.2018, “Mbi ndarjen e gjyqtarëve në trupa gjykues”, kandidatja është caktuar të gjykojë në disa trupa gjykues në periudha të ndryshme.

Përfundimisht, nga ana e saj plotësohet edhe kriteri minimal i përcaktuar nga ligji për 5 vjet përvojë profesionale në fushën e së drejtës civile, në 7 vjet të përgjithshme.

Gjithashtu nga verifikimet ka rezultuar që nuk ka kriteret të cilët do ta pengonin në konkurrimin e mëtejshëm siç është mospasja/ekzistencën e ndonjë mase disiplinore apo papajtueshmërie ambientale.

Në këtë kuadër ju propozohet projekti i përgatitur i vendimmarrjes ku në dispozitiv ju sugjerohet të miratoni:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr.244 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet nr.244 dhe nr. 246 datë 02.05.2024.

3. Një kopje e arsyetuar i njoftohet kandidates {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime për sa u parashtrua nga relatori?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 244 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr.244 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr.244 dhe nr. 246 datë 02.05.2024.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.07.2024)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 244, nr. 245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:14 dhe mbaroi në orën 14:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Markelian Koça | (anëtar) |

42

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 09.07.2024 (Pika 7)***

8. *Yllka Rupa* (anëtare)
9. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Valbona Bala, eksperte pranë EWWMI/INL.*
5. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
6. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 244, nr. 245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 7 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 244, nr. 245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së

verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Toro.

Alban Toro: Përkatësisht me vendimet nr. 244, nr. 245 dhe nr. 246, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor është proceduar me hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në fushën e të drejtës civile. Një nga kandidatet është edhe zonja {...}, aktualisht gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Edhe për të ka filluar procedura e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë pranë kësaj gjykate, me vendimin nr. 266, 24.05.2024, me cilësinë e relatorit të përcaktuar me këtë vendim marrje kam administruar aktet e nevojshme të cilat do të provojnë verifikimin dhe plotësimin e kriterëve të parashikuara përkatësisht nga neni 47/4, 48/8, dhe 8 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Nga ky administrim ka rezultuar se sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datën 30.06.2006 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2012. Me dekretin nr. {...}, datë 10.11.2011 të Presidentit të Republikës caktohet për të kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Me dekretin nr. {...}, datë 23.01.2014 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër. Me vendim nr. 23, datë 14.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor komandohet në pozicionin “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, për një periudhë 2 (dy) vjeçare.

Me vendim nr. 28, datë 20.01.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor i përsëritet komandimi në pozicionin “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, për një periudhë 2 (dy) vjeçare. Me vendim nr. 57, datë 31.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet për shkak të suprimimit të pozicionit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me vendimin nr. 17, datë 18.01.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor deklarohet përfundimi i kohëzgjatjes së komandimit në pozicionin “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit

Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve dhe kthimi në pozicion si gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ku dhe aktualisht ushtron funksionin e saj. Vjetërsia është 12 vite. Znj. {...} nuk rezulton të ketë masa disiplinore në fuqi.

Në këtë kontekst ajo plotëson përvojën minimale prej 7 vjetësh të kërkuar nga ligji në rastet e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Apelit.

Në lidhje me përvojën specifike, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, rezultoi se: “Pasi u njohëm me kërkesën tuaj për informacion në lidhje me përvojën profesionale specifike si gjyqtar në fushën e drejtësisë civile të znj {...}, ju bëj me dije se: Për periudhën janar të vitit 2014 deri më janar të vitit 2020, znj {...} ka ushtruar detyrën si gjyqtare pranë ish-Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Gjithashtu znj. {...} ka gjykuar të gjitha kategoritë e çështjeve, konkretisht çështje penale, civile, familjare dhe tregtare, pasi Gjykata Dibër, për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve nuk ka qenë e ndarë në seksione apo dhoma të veçanta penale dhe civile.”

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, rezultoi se: “Në lidhje me përvojën profesionale të gjyqtarës znj.{...} pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për periudhën 10.11.2011 deri me 23.01.2014 është si me poshtë: 1- Me vendimin nr. {...} Prot, datë 18.01.2012 ka qenë gjyqtare pranë seksionit civil. Ky urdhër ka qenë edhe për vitin 2013.”

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton se sipas urdhrin vendimit nr.97 datë 27.03.2024 nga Këshilli i Gjykatës është vendosur që gjyqtarja të gjykojë në dhomën penale, seksionin i të miturve.

Ndërkohë, lidhur me përvojën profesionale të kandidatës si “Nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Etik dhe Profesional në Këshillin e Lartë Gjyqësor, në kushtet kur Ligji 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, konkretisht në nenin 53, pika 9 e tij, parashikon vetëm llogaritjen e kësaj përvoje si përvojë profesionale në shkallë të parë, pa e lidhur me një fushë specifike të së drejtës, vlerësohet se, për sa kohë nuk ka një specifikim të tillë nga ligji, përvoja e kandidatës

do të konsiderohet si përvojë profesionale specifike në fushën e të drejtës civile, penale dhe administrative.

Pra edhe në këtë kontekst, nga të dhënat rezulton që zonja {...} plotëson edhe kriterin minimal të parashikuar nga ligji për përvojën specifike në fushën e të drejtës civile, atë të 5-vjeçarit.

Nuk rezulton që të ketë kritere të tilla që do të pengonin kandidimin e mëtejshëm siç është masa disiplinore dhe papajtueshmëria ambientale dhe në këtë kontekst është përgatitur projekti në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr.244, nr.245 dhe nr.246 datë 02.05.2024, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr.244, nr.245 dhe nr.246 datë 02.05.2024.

3. Një kopje e arsyetuar i njoftohet kandidatës {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 244, nr. 245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr.244, nr.245 dhe nr.246 datë 02.05.2024, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr.244, nr.245 dhe nr.246 datë 02.05.2024.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.07.2024)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimin nga kandidatja znj. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 244 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:14 dhe mbaroi në orën 14:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Valbona Bala, eksperte pranë EWTI/INL.*
5. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
6. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 244 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me pikën 8 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 244 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, për të cilin është

përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Toro.

Alban Toro: Një nga kandidatet e cila ka kandiduar për pozicionet e hapura pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në të drejtën civile, përkatësisht me vendimet nr. 244, 246, 02.05.2024, është edhe zonja {...}, aktualisht gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Edhe për këtë gjyqtare ka filluar procedura e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë pranë gjykatës së apelit me vendimin nr. 266, 24.05.2024, ku dhe është caktuar relatori përkatës.

Me cilësinë e relatorit të kësaj kandidateje, kam administruar aktet të cilat do të provonin ekzistencën e kriterëve të parashikuara në nenet 8, 47/4, 48/8 të ligjit “Për statusin”, duke administruar aktet përkatëse.

Nga këto akte ka rezultuar se znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datën 05.07.2002 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2008. Me dekretin nr. {...}, datë 05.10.2007 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare dhe caktohet për të kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekretin nr. {...}, datë 25.03.2009 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Me vendimin nr. {...}, datë 23.07.2014 të Këshillit të Lartë Drejtësisë emërohet Kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Me vendimin nr. 293, datë 09.09.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor miratohet zgjedhja si Anëtare e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, me mandat 4-vjeçar. Me vendimin nr. 97, datë 06.03.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet përkohësisht për një periudhë deri në 1 (një) vit, si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nga data 01.05.2023 ka ushtruar funksionin e gjyqtares pranë kësaj gjykate. Me vendimin nr. 456, datë 24.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet sipas procedurës së lëvizjes paralele, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ku dhe aktualisht ushtron funksionin e saj. Vjetërsia është 16 vite. Nuk rezulton të ketë masa disiplinore në fuqi.

Për rrjedhim zonja {...} gëzon kriterin apo përvojën mbi 7 vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë.

Në lidhje me përvojën specifike, sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje, rezulton që kandidatja referuar urdhrin nr. {...} datë 10.01.2011; nr.{...} datë 04.01.2013 dhe vendimit nr.{...} prot., datë 25.06.2019 të kryetarit të gjykatës është vendosur që të gjykojë çështje civile /tregtare si dhe penale.

Nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton se nga periudha 05.10.2007-31.12.2008, është caktuar të kryejë stazhin profesional (1vit), ku gjatë këtij stazhi gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 53 çështje civile me natyrë të përgjithshme, 11 kërkesa civil, 2 kërkesa penale dhe 4 çështje penale. Me vendimet nr. 97, datë 06.03.2023 dhe nr. 456, datë 24.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është transferuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Këshilli i Gjykatës ka vendosur që gjyqtarja të gjykojë në seksionin civil/tregtar sipas urdhrave nr. 174 datë 01.06.2023 dhe vendimit nr.97 datë 27.03.2024.

Pra edhe në lidhje me kriterin e përvojës minimale specifike, atë 5-vjeçare brenda 7 viteve, rezulton që zonja {...} ta plotësojë.

Gjithashtu nuk verifikohet të ekzistojnë kritere të cilat do ta ndalonin kandidimin e saj, siç është pasja e një mase disiplinore në fuqi, apo papajtueshmëri ambientale.

Për rrjedhim nga ana e relatorit është përpiluar projekti në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr.244 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr.244 dhe nr. 246 datë 02.05.2024

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 244 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr.244 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të

Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr.244 dhe nr. 246 datë 02.05.2024.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për efektivitet, 5 minuta pushim.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.07.2024)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimin nga kandidati znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 244 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:14 dhe mbaroi në orën 14:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
5. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
6. ***Alban Toro*** (anëtar)
7. ***Markelian Koça*** (anëtar)
8. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

54

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 09.07.2024 (Pika 9)***

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Valbona Bala, eksperte pranë EWMI/INL.*
5. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
6. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 244 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Në vijim të mbledhjes, vazhdojmë me pikën 9 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 244 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, për të cilin është

përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Me vendimin nr. 244, të vitit 2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e të drejtës civile.

Në lidhje me këtë pozicion ka paraqitur kërkesë si kandidatë, pasi ka shprehur interesin, zonja {...}, aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Me vendimin nr. 266, të vitit 2024 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 247, të vitit 2024 si dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet 244, 245, 246, të vitit 2024”, Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi:

Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 247, të vitit 2024; si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 244, nr. 245 dhe nr. 246, të vitit 2024.

Caktimin e relatorit si më poshtë: 14. Për kandidatin znj. {...}, jam caktuar unë si relator i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore.

Në mënyrë të përmbledhur po paraqes rezultatet e verifikimit për kriteret ligjore të kërkuara nga neni 47 i ligjit “Për statusin”.

Fillimisht për përvojën profesionale minimale për ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë në rastin konkret në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ky kriter gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 244 të vitit 2024, ku si referencë edhe në këtë vendim është përmendur, është parashikuar neni 47, pika 4, e Ligjit për Statusin, dispozitë e cila parashikon se: “Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë,

56

nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vite në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.

Në lidhje me përvojën fillimisht të përgjithshme profesionale të kandidates, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidati, evidentohet se ajo ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2009, ndërkohë ajo është emëruar si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, (gjatë periudhës së stazhit profesional) për periudhën 07.01.2009 deri në qershor të vitit 2010, ku ka gjykuar çështje të të gjitha natyrave.

Sipas burimit të përcjellë në rrugë elektronike, në datë 10.06.2024, nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, rezulton se: “Znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi. Ka marrë titullin Jurist, pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, më datë 05.07.1998. Ajo ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2009.

Me dekretin e Presidentit të Republikës datë 07.01.2009 ajo caktohet për të kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me dekretin nr. {...}/2010 të Presidentit të Republikës ajo emërohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Me vendimin nr. {...}, datë 03.05.2013 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë kandidates i jepet leje për të shërbyer si ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Lartë, për një periudhë 3-vjeçare.

Me vendimin nr. {...}, datë 20.12.2013 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë transferohet si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me vendimin nr. {...}, datë 27.05.2016 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, pas përfundimit të afatit të shërbimit si ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë, rikthehet në pozicionin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pra nga data 27.05.2016 e në vijim aktualisht ajo ushtron funksionin e gjyqtares në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Vjetërsia në funksionin e magjistratit është 15 vite.

Zonja {...} nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Nga të dhënat e përmendura më lart dhe të verifikuara nga ana e Komisionit rezulton se nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, zonja {...} deri në momentin e kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 244 të vitit 2024, rezulton të ketë mbi shtatë vjet përvojë profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë dhe magjistrat i komanduar për pozicionin përkatës, e përmenda nga viti 2016 deri sot që ne po flasim, deri në momentin që ajo paraqiti kërkesën për shprehje interesi, plotëson afatin minimal kohor prej 5 vjetësh si përvojë minimale profesionale në fushën e së drejtës civile, pozicioni i cili është shpallur me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Më tej kjo përvojë plotësohet edhe me përvojën që ajo ka pasur gjatë kohës që ka ushtruar funksionin e gjyqtares në pozicionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Pogradec si dhe në pozicionin e magjistrates së komanduar në Gjykatën e Lartë.

Në lidhje me të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, siç thashë, rezulton që zonja {...} të ketë mbi 5 vjet përvojë profesionale në fushën e së drejtës civile.

Për zonjën {...} u verifikua edhe kriteri i mospasjes masë disiplinore, përveç verifikimeve të bëra nga ana jonë, morëm edhe deklaratën e saj, verifikuam të gjitha dokumentet e nevojshme për të arritur në një konkluzion të drejtë dhe përfundimisht na ka rezultuar nga verifikimi që zonja {...} nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Njëkohësisht edhe për sa i përket kriterit të papajtueshmërisë ambientale, pas verifikimit të bërë nga ana jonë, rezulton që zonja {...} në rastin e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit, referuar rrethanave aktuale kur është bërë edhe verifikimi, rezulton se nuk do të ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë ambientale.

Kështu që ne mendojmë që verifikimet janë të plota në lidhje me kriteret ligjore formale për kandidim për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Zonja {...} i plotëson të gjitha këto kritere. Ndodhur në këto kushte ne propozojmë verifikimin e plotësimit të kritereve nga zonja {...} që lidhen me përvojën profesionale, mospasjen e masës disiplinore në fuqi dhe mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale, dhe

të vijojë më tej procedura e verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit z. Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati znj. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 244 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 244, datë 02.05.2024, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimin e Këshillit nr. 244 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.07.2024)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:14 dhe mbaroi në orën 14:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Markelian Koça | (anëtar) |

61

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 09.07.2024 (Pika 10)***

8. *Yllka Rupa* (anëtare)
9. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerita Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Valbona Bala, eksperte pranë EWWMI/INL.*
5. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
6. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 10 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së

verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Koça.

Markelian Koça: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar anëtarë!

Në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, ju paraqesim mbledhjes plenare projektvendimin “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Në relacionin bashkëlidhur ju bëj me dije se me vendimin nr. 245, 02.05.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e të drejtës civile. Me vendimin nr. 246, 02.05.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e të drejtës civile.

Afati i kandidimit për këto dy procedura ka qenë data 16.05.2024 dhe procedura është shoqëruar me njoftimet përkatëse dhe publikimin e vendimeve respektive të shpalljes së vendeve të lira në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Brenda afatit të përcaktuar ka aplikuar edhe z. {...}, aktualisht gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Me vendimin nr. 266, datë 24.05.2024 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallura me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024; si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 244, nr. 245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli ndër të tjera ka vendosur:

Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në këto gjykata sipas vendimeve përkatëse, nr. 247, datë 02.05.2024, nr. 244,

63

nr. 245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, dhe caktimin e relatorit për kandidatin zotin {...}, të anëtarit z. Markelian Koça.

Në datën 27.05.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara ligjore dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor është njoftuar kandidati për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, caktimin e relatorit për këtë procedurë verifikimi, të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit apo çdo anëtar tjetër të Këshillit.

Brenda afatit ligjor nuk është ushtruar e drejta e ankimit në lidhje me relatorin apo anëtarë të tjerë të Këshillit.

Në vijim është njoftuar për plotësim dokumentacioni në kuadër të procedurës së verifikimit dhe kriterëve ligjore të kandidimit dhe brenda afatit kandidati ka depozituar rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit.

Në lidhje me verifikimet e nevojshme për t'u kryer është marrë gjithashtu kontakt dhe u kërkuar informacion nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe gjykata përkatëse ku z. {...} ka punuar, në lidhje me verifikimin e kriterit të përvojës profesionale minimale dhe të përvojës specifike profesionale.

Nga verifikimet ka rezultuar se z. {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, në vitin 1995. Në vitin 1999, në përfundim të Shkollës së Magjistraturës është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ndërsa nga informacioni nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative rezulton se është diplomuar për drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 11.07.1995. Ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2000, dhe në Universitetin e Tiranës ka përfunduar studimet Master në “E drejtë civile” në vitin 2006 dhe në vitin 2016 ka fituar gradën shkencore “Doktor” në “E drejta e pronësisë”.

Me vendimin nr. {...}, datë 04.09.1999 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet provizorisht në Gjykatën e Rrethit Tiranë si gjyqtar.

Me dekret nr. {...}, datë 27.09.2000 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me vendimin nr. 137, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, nga data 01.05.2023 ushtron

funksionin si gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit, 24 vite.

Nuk rezulton të ketë masa disiplinore.

Nga sa më lart u parashtrua, rezulton që z. {...} të ketë mbi 7 vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtar e gjykatës së shkallës së parë.

Në lidhje me përvojën specifike për një periudhë 5-vjeçare në fushën e të drejtës civile, nga informacioni i marrë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë rezulton që gjenden urdhra të kryetarëve për ndarjen në seksione prej vitit 2008. “Gjyqtar {...} ka gjykuar në seksionin administrativ në vitin 2008 dhe më pas nga viti 2011 e në vazhdim në seksionin civil / tregtar...”, duke gjykuar çështje të natyrës administrative dhe civile.

Dhe për sa më lart rezulton që të ketë mbi 5 vite përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile.

Është verifikuar kriteri i mospasjes së masës disiplinore. Është administruar deklarata e z. {...} sipas të cilës deklarohet se nuk ka masë disiplinore. Po ashtu nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, rezulton të mos ketë masa disiplinore.

Në lidhje me kriterin e papajtueshmërisë ambientale është administruar deklarata e kandidatit sipas së cilës në rastin e emërimit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nuk do të ndodhej në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3 të nenit 8, të ligjit 96 “Për statusin”.

Gjatë verifikimit nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale, për sa ai kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Në këto kushte, relatori ia ka përcjellë Komisionit fillimisht materialin duke vlerësuar se është i plotë dhe nuk ka nevojë për verifikime të mëtejshme dhe Komisioni me vendimin datë 21.06.2024, duke e konsideruar të plotë procedurën e verifikimit për tre kriteret formale të kandidimit për z. {...}, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë, pra në mbledhjen plenare, duke propozuar që të vendoset verifikimi i plotësisht nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në

detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Së dyti, vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimin e Këshillit nr. 245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024.

Ju faleminderit për vëmendjen.

Ilir Rusi: Faleminderit z. Koça!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në

fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.07.2024)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimin nga kandidati z. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallura me vendimin nr. 247 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:14 dhe mbaroi në orën 14:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
5. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
6. ***Alban Toro*** (anëtar)
7. ***Markelian Koça*** (anëtar)
8. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

68

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 09.07.2024 (Pika 11)***

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Valbona Bala, eksperte pranë EWTMI/INL.*
5. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
6. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallura me vendimin nr. 247 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 11 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallura me vendimin nr. 247 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit

për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar kolegë!

Po paraqes projektvendimin dhe relacionin bashkëlidhur që lidhet me gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm për verifikimin e kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të kandidatit, z. {...}.

Me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e më sipër, ka kandiduar edhe z. {...}.

Me vendimin nr. 266, datë 24.05.2024, për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme për pozicionin e lirë të shpallura me vendimin nr. 247, ndër të tjera, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024; [...].

Caktimin e relatorit si më poshtë: 4. Për kandidatin z. {...}, në këtë procedurë verifikimi për kriteret formale jam shortuar unë si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, që po paraqes përpara jush edhe relacionin për verifikimin e kriterëve ligjore.

Më tej, në lidhje me kriteret ligjore të verifikimit, në ndryshim nga kandidatët e tjerë, meqenëse zoti {...} është kandidat për ngritjen në detyrë në një pozicion të shpallur me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor në Gjykatën e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, fillimisht kriteret ligjore të kandidimit janë katër të tilla, të parashikuara si të tilla në nenin 47 të ligjit “Për statusin”. Unë po i citoj më poshtë dhe verifikimin për secilin kriter

Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i “përvojës minimale profesionale”.

“Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimit nr. 247 datë 02.05.2024, i cili është i parashikuar si kriter në nenin 47, pika 2, të Ligjit për Statusin.

Sipas verifikimeve që kemi bërë dhe informacioneve që ne kemi marrë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...} rezulton se:

Ai ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, e ka marrë pranë Universitetit të Tiranës më datë 09.07.2009. Ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2015.

Me dekretin nr. {...}, datë 31.10.2014 të Presidentit të Republikës ai është caktuar përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Më tej me dekretin nr. {...}, datë 23.06.2016 të Presidentit të Republikës është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Me vendimin nr. {...}, datë 21.12.2018 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë.

Me vendimin nr. {...}, datë 11.09.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor deklarohet përfundimi i transferimit të përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe kthimi në pozicion e mëparshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Me vendimin nr. 136, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër”, nga data 01.05.2023 dhe në vijim ai ka ushtruar funksionin si gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Më tej, me vendimin nr. 214, datë 25.04.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor ai transferohet sipas procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ku aktualisht vazhdon të ushtrojë funksionin e gjyqtarit në këtë pozicion në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 9 vite.

Zoti {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në lidhje me përvojën minimale specifike profesionale:

Zoti {...} ushtron funksionin fillimisht pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, sot Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër prej datës 28.06.2016 (janë verifikimet e bëra duke marrë informacionin nga gjykatat nëpër të cilat zoti {...} ka ushtruar funksionin e tij si gjyqtar).

Informacioni që unë po prezantoj lidhet me të dhënat e paraqitura nga Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër, më pas Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Ai prej datës 28.06.2016 ka ushtruar funksionin pranë kësaj gjykate. Me vendimin nr. {...}, datë 21.12.2018 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është transferuar përkohësisht si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, duke u rikthyer përsëri pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në zbatim të vendimit nr. 176 të viti 2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjatë kësaj periudhe ai ka punuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, sot Gjykata e Shkallës e Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe ka qenë fillimisht pjesë e Dhomës Civile të kësaj gjykate për periudhën 13.07.2016 deri më datë 28.07.2017, kur po me Urdhër të Kryetarit të gjykatës ka kaluar pjesë e seksionit penal, duke vijuar të gjykojë ngarkesën civile deri në përfundim të çështjeve që ai kishte në shqyrtim, siç do e referojmë nga të dhëna statistikore që janë pjesë e këtij relacioni.

Prej datës 28.07.2017 - 21.12.2018 ka qenë pjesë e seksionit penal në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke vijuar gjykimet e ngarkesës së marrë më përpara.

Nga data 21.12.2018 deri në tetor të vitit 2019 ka qenë pjesë e trupës gjyqësore që ka gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, çështje të kategorisë penale dhe civile, pasi kjo gjykatë gjatë kësaj periudhe kohe ka patur në përbërje vetëm dy gjyqtarë. Pra zoti {...} për periudhën afërsisht 1-vjeçare të ushtrimit të funksionit në Gjykatën e Shkallës së Parë Pukë, ka gjykuar të gjitha llojet e çështjeve që kanë ardhur pranë asaj gjykate, si penale ashtu edhe civile.

Në vijim nga tetori i vitit 2019 dhe më tej, gjyqtari {...} ka qenë pjesë e seksionit penal dhe seksionit penal për të mitur, duke marrë ngarkesë civile vetëm në raste të ezaurimit të trupave gjyqësore në përbërje të seksionit civil.

Pra sipas informacionit rezulton që qenia e gjyqtarit në Gjykatën fillimisht të rrethit gjyqësor Shkodër dhe më pas gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, duke përfshirë edhe periudhën e transferimit, është një periudhë në të cilën gjyqtari ka plotësuar përvojën minimale specifike të kërkuar nga neni 47 i ligjit “Për statusin”.

Më tej sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë, për kandidatin rezulton se: “...në referencë të të dhënave të viteve, 2018 - 2019, kohë në të cilën gjyqtari ka ushtruar funksionet si gjyqtar pranë kësaj gjykate, për të gjithë periudhën që ka gjykuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Pukë, gjyqtari ka gjykuar të gjitha llojet e çështjeve civile, penale, familjare, pasi kjo gjykatë nuk është e ndarë në seksione.”

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 247, të vitit 2024, rezulton se kandidati ka mbi pesë vite përvojë specifike profesionale në fushën e të drejtës penale.

Kriteri i dytë lidhet me dhënien e pëlqimit të tij dhe familjarëve të tij me të cilët ai bashkëjeton, për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Ka rezultuar se në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kandidati ka depozituar:

Formularin “Vetëdeklarim (i gjyqtarëve dhe prokurorëve)”, Shtojca B, Deklarata 1, plotësuar dhe firmosur rregullisht nga kandidati, z. {...}, i datës 10.06.2024, ku ai pranon të gjitha kushtet e parashikuara në ligjin nr. 95 të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;

Formulari i dytë është formular “Vetëdeklarimi i anëtarëve të familjes së gjyqtarëve dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar” dhe ky formular është plotësuar sipas Shtojcës B, Deklarata 3, që është formular që i bashkëlidhet vetëdeklarimit që duhet të bëjë familjari i afërm me të cilin

kandidati bashkëjeton, dhe në këtë rast ky familjar është nënshkruar, plotësuar rregullisht nga bashkëshortja e tij, znj. {...}, dhe mban datën 04.06.2024.

Sa më sipër rezulton se kandidati dhe familjarët e tij të afërt, konkretisht bashkëshortja, në respektim të përcaktimeve ligjore, kanë dhënë pëlqimin e shprehur sipas formularëve përkatëse tip, për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016.

Për kriterin e mospasjes së masës disiplinore në fuqi. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 04.06.2024, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Sipas informacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, rezulton se kandidati z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në lidhje me kriterin e papajtueshmërisë ambientale, i parashikuar si i tillë në nenin 8, pika 5 e ligjit “Për statusin”, kandidati ka depozituar edhe në lidhje me këtë kriter formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 04.06.2024, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se nuk do të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Njëkohësisht, gjatë verifikimit të bërë nga ana jonë, nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ai kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për të cilën ai ka shprehur edhe interesin e tij.

Ndodhur në këto kushte, ne mendojmë se si Komision kemi bërë verifikimet e duhura në lidhje me katër kriteret ligjore që kërkohen për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 247, të vitit 2024, për Gjykatën e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, pozicion për të cilin ka shprehur interes z. {...}.

Ndodhur në këto kushte ne japim mendimin tonë pozitiv për pranimin e projektvendimit të dërguar për miratim në Këshill.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit z. Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallura me vendimin nr. 247 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallura me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 247 datë 02.05.2024, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për

Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 247 datë 02.05.2024.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 11 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.07.2024)

Pika 12 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 79, nr. 80 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor” / “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 80 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi). (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 18.06.2024).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:14 dhe mbaroi në orën 14:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 2. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Gentiana Muçaj*** (anëtare)
- 5. Ridvan Hado*** (anëtar)

77

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 09.07.2024 (Pika 12)***

6. *Alban Toro* (anëtar)
7. *Markelian Koça* (anëtar)
8. *Yllka Rupa* (anëtare)
9. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Valbona Bala, eksperte pranë EWMI/INL.*
5. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
6. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

12. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 79, nr. 80 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor” / “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 80 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi). (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 18.06.2024).

Ilir Rusi: Në vijim, vazhdojmë me pikën 12 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 79, nr. 80 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor” / “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 80 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës relacioni përkatës. Relator z. Kurushi. Kjo çështje është shtyrë nga mbledhja plenare e datës 18.06.2024. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Në vijim vazhdojmë me prezantimin.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar kolegë!

Relacioni i radhës është i përgatitur në mënyrë alternative për dy projektvendime: “Për kualifikimin e kandidatit z. Shehu dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 79, nr. 80 dhe nr. 81”, si dhe në mënyrë alternative edhe projektvendimi i radhës që bën fjalë “Për kualifikimin e z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 80 dhe nr. 81”.

Me disa vendime të datës 20.02.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi katërmbëdhjetë procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimin nr. 79, nr. 80 dhe nr. 81, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet të lira në fushën e të drejtës civile (i referohet pozicionit nr. 79) dhe në fushën e së drejtës penale (i referohet pozicioneve nr. 80 dhe nr. 81).

Rezultatet e verifikimit për kandidatin për pozicionet civile dhe pozicionet penale.

Kandidati u verifikua nga kriteri i “Përvojës profesionale specifike”.

Për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, në rastin konkret në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, përvoja profesionale specifike gjen pasqyrim në shkronjën “a”, të pikës 5, të vendimit nr. 79/2024, vendimi nr. 80/2024, dhe vendimi nr. 81/2024. Këto kritere i referohen nenit 43 pika 6, e Ligjit për Statusin, i cili thotë se: “Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë pesë viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën e së drejtës për pozicionin e lirë ...”.

Në lidhje me përvojën specifike në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, nga verifikimet e kryera, rezulton se për kandidatin: “Në lidhje me përvojën në fushën e së drejtësisë civile, gjatë 5-vjeçarit të fundit, ky gjyqtar ka qenë caktuar në seksionin penal prej vitit 2016 e në vijim, por ka gjykuar edhe çështje civile si më poshtë: Çështje që e ngarkon ligji procedural si gjyqtar kompetent (janë çështje të rikthyera nga Gjykata e Lartë, fazën e dytë të pjesëtimit të pasurisë). Në lidhje me këtë informacion përcillen të dhënat statistikore si dhe vendime dhe akte të nxjerra nga sistemi në lidhje me çështje ku është vendosur përjashtimi apo ka qenë anëtar i trupit gjykues.

Bashkëlidhur është edhe tabela përkatëse ku parashikohet edhe ngarkesa që ka pasur gjyqtari në 5 vitet e fundit duke filluar nga viti 2019 (si viti më i largët i fundit), deri në vitin 2023 që është viti i pestë i fundit, pasi viti 2024 nuk është vit i plotë dhe nuk është marrë si përvojë për vitin 2024.

(Lexohet nga tabela)

Në vitin 2019 ai ka gjykuar 4 çështje civile, 840 çështje penale, gjithsej 844.

Në vitin 2020, ka gjykuar 4 çështje civile, 856 (*lapsus, sipas tabelës është 586 çështje penale*) çështje penale.

Viti 2021, 2 çështje civile, 555 çështje penale.

Viti 2022, 3 çështje civile, 624 çështje penale.

Viti 2023, 2 çështje civile dhe 761 çështje penale.

Vlen të theksojmë se përpara vitit 2019, pra përpara vitit 2016, gjyqtari {...} ka qenë pjesë e seksionit civil në Gjykatën e Shkallës së Parë Shkodër dhe në këtë seksion nga viti 2014 deri në vitin 2016 por edhe më tej, ai ka gjykuar çështje të natyrës civile.

Përmend vitin 2014, ai ka gjykuar 314 çështje civile.

Për vitin 2015 ka gjykuar 493 çështje civile.

Për vitin 2016 ka gjykuar 210 çështje civile.

Për vitin 2017 bie pastaj ngarkesa e gjykimit të çështjeve civile për shkak se në vitin 2016 siç e thashë, ai ka shkuar në seksionin penal.

Në lidhje me këtë lloj ngarkese, ne si Komision kemi propozuar dhe i propozojmë Këshillit që për sa i përket përvojës specifike minimale profesionale për fushën penale, kandidati i plotëson kërkesat e parashikuara nga neni 43 i ligjit “Për statusin” sepse ai brenda 5 viteve të fundit ka më tepër se sa një vit përvojë në fushën përkatëse të së drejtës që kërkon kjo dispozitë.

Në lidhje me pozicionin civil (i referohemi nenit 43 të ligjit “Për statusin”), për pesë vitet e fundit, gjyqtari, siç e përmenda më lart, ka gjykuar gjithsej në vitin 2019 - 4 çështje, në vitin 2020 – 4 çështje civile, në vitin 2021 – 2 çështje civile, në vitin 2022 – 3 çështje civile dhe në vitin 2023 – 2 çështje civile. Pra numri i çështjeve, i gjykimit të çështjeve brenda pesë viteve të fundit, në raport me çështjet penale të gjykuara është shumë i dukshëm dhe është me natyrë penalizuese për gjyqtarin, referuar nenit 43 të ligjit “Për statusin”. Kështu që referuar përvojës specifike profesionale minimale, ne propozojmë që për dy pozicionet penale për të cilat kandidati ka shprehur interes, kriteri i përvojës minimale specifike në fushën e së drejtës përkatëse është i plotësuar nga kandidati. Ndërsa për fushën civile që i referohet pozicionit nr. 79, ne i propozojmë Këshillit që të vijojë më tej hetimin dhe mundësinë e njoftimit të një gjetjeje për kandidatin në lidhje me ngarkesën e pakët, llojin e çështjeve që ka gjykuar si dhe pozicionin që ka mbajtur ky në trupin gjykues që ka gjykuar ndoshta këto çështje të natyrës civile. Kështu që për këtë pjesë, pra për pjesën që i referohet përvojës minimale profesionale për fushën e së drejtës civile, ne si Komision nuk japim mendimin pozitiv ose negativ të plotësimit të këtij kriteri nga ana e këtij kandidati, për sa kohë duhet të shterojmë të gjithë procedurën tonë që lidhet edhe për mundësinë e njoftimit të gjetjes mbi atë numër që na është dhënë nga statistikat e Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, për të cilat gjyqtari ka dhënë vendim qoftë në pozicionin e gjyqtarit të vetëm, qoftë në pozicionin e anëtarit të trupit gjykues, por të marrim edhe një informacion në lidhje edhe me natyrën e çështjeve; çfarë lloj çështjesh ka gjykuar (ka gjykuar çështje me palë kundërshtare apo pa palë kundërshtare, ka gjykuar çështje themeli apo çështje të

natyrës procedurale civile). Mbase ky informacion që do marrim nëpërmjet gjyqtarit por edhe nëpërmjet Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, më falni, Shkodër, mund të jetë i mjaftueshëm për të vendosur në lidhje me këtë kriter, që është një kriter ligjor i parashikuar nga neni 43 i ligjit “Për statusin”.

Në lidhje me kriteret e tjera, të mospasjes masë disiplinore në fuqi si dhe kriterin e papajtueshmërisë ambientale, ne vlerësojmë se gjyqtari i plotëson të dyja këto kritere, po t’i referohemi rastit kur ky gjyqtar ka shprehur interesin e tij për të lëvizur paralelisht në procedurën e lëvizjes paralele, për pozicionet penale që janë ato me nr. 80 dhe 81. Ndërsa, thashë, për procedurën që lidhet me pozicionin e së drejtës civile, për sa kohë kriteri i përvojës minimale në fushën e së drejtës civile kërkon një hetim dhe një verifikim më të thelluar në lidhje edhe me mundësinë e gjetjes dhe njoftimit të saj ndaj kandidatit, për dy kriteret e tjera, në lidhje me këtë pozicion unë mendoj të shprehem pasi të ezaurojmë përfundimisht të gjithë verifikimet që ne bëjmë për tre kriteret ligjore që parashikon neni 43 i ligjit “Për statusin”.

Pra, përfundimisht, që mos të zgjatem shumë, unë i propozoj Këshillit që të pranohet, nëse ata e vlerësojnë, projektvendimi i renditur i dyti në materialin që ne kemi dërguar në mbledhje, sipas të cilit ne propozojmë kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 80, 81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ndërsa për pozicionin tjetër, ne propozojmë që të vijojmë më tej verifikimet mbi mundësinë e gjetjes dhe njoftimit të gjetjes kandidatit. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit z. Kurushi!

Keni diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk keni diskutime, të vijohet me votimin e projektvendimit përkatës në lidhje me vijimin e procedurave për vendimin nr. 80, 81.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Nuk dëgjohej vota.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Edhe unë jam dakord me propozimin për kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 80 dhe 81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 80 dhe nr.81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 80 dhe nr. 81 datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj pike, po z. Kurushi!

Klodian Kurushi: Në lidhje me pozicionin e hapur me vendim të Këshillit nr. 79 të vitit 2024, që i referohet pozicionit në fushën e së drejtës civile, ne si Komision i propozojmë Këshillit që të vijojnë më tej verifikimet si dhe të vijojë edhe mundësia e njoftimit të gjetjes nëse gjatë verifikimit do ekzistojë/do lindi nevoja për gjetje, të ekzistojë edhe mundësia e njoftimit të gjetjes për kandidatin në lidhje me verifikimin e

83

tre kriterëve ligjore që kërkon neni 43 i ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Keni diskutime apo propozime për sa u propozua nga z. Kurushi?

(Nuk ka diskutime apo propozime.)

Meqenëse nuk keni propozime, vazhdojmë në votimin e...

Ilir Rusi: Në vijim të diskutimeve, po z. Kurushi!

Klodian Kurushi: Edhe një herë, po riformuloj edhe një herë propozimin.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Klodian Kurushi: Atëherë, propozimi në këtë rast është që ne propozojmë për pozicionin nr. 79, të shpallur me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, që i përket pozicionit në fushën e së drejtës civile në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, procedura e lëvizjes paralele, ne i propozojmë Këshillit që të vijojmë me verifikimin e kriterëve ligjore të parashikuara nga neni 43 i ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi për ndërhyrjen dhe për saktësinë e propozimit tuaj në lidhje me këtë çështje.

Ka diskutime për sa u propozua së fundmi nga zoti Kurushi?

(Nuk ka diskutime.)

Vazhdojmë atëherë me votimin e propozimit të z. Kurushi.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Sipas propozimit të z. Kurushi, do të vijojë procedura e verifikimit të tre kritereve në lidhje me pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 79, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me shqyrtimin e kësaj pike përfundon shqyrtimi i çështjeve me dyer të hapura.

Tashmë do vijojë mbledhja e Këshillit të Lartë Gjyqësor me dyer të mbyllura, për shkak të natyrës së çështjeve.

* * *

(Pika 12 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor